



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë -Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 220/2023
Datë 12.12.2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në pajtim me nenin 323 (paragrafi 1), nenin 328 (paragrafi 1) dhe nenin 330 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin nr. 08/L-102, në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përmbartuesit privat

1. **Z. Muharrem (Ukë) Bajraktari**, emërohet përmbartues privat për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë.
2. Selia e të emëruarit do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës Themelore në Pejë.
3. I emëruari, para caktimit të ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbartuese në pajtim me paragrafin 4 të nenit 331 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore është i obliguar që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e dhënies së betimit të ofroj dëshmitë se i plotëson kushtet sipas nenit 332 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU
Ministre e Drejtësisë

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij vendimi mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Vendimi iu dërgohet:

- *Përmbauesit privat të emëruar;*
- *Odës së Përmbauesve Privat;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Departamentit për Profesione të Lira/MD;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.*